



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 111, datë 30.03.2023

PËR

MIRATIMIN E SHTYRJES SË AFATIT TË PAGESËS SË TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE PËR VITIN 2023, NGA DATA 20 PRILL 2023 NË DATËN 31 MAJ 2023 PËR SHKAK TË PROBLEMATIKAVE TË NDRYSHME

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, Ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, Ligjit nr.68/2017, “Për financat e e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2009 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 149, datë 22.12.2023 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Durrësit për vitin 2023” dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Durrës, me propozim të Kryetarës së Bashkisë,



KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :


1. Miratimin e shtyrjes së afatit të pagesës së taksave dhe tarifave vendore për vitin 2023, nga data 20 Prill 2023, në datën 31 Maj 2023 për shkak të mungesës së stafit në sektorin e të ardhurave pranë drejtorisë së taksave dhe tarifave vendore.

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të Bashkisë Durrës.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55, të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore“ i ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Durrës.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 03.04.2023





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT Durrës


Nr. 232 / 15 prot.

Durrës, më 06.04 .2023

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS**

**KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS**



Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.111 datë 30.03.2023 “Për miratimin e shtyrjes së afatit të pagesës së taksave dhe tarifave vendore për vitin 2023, nga data 20 prill 2023 në datën 31 maj 2023 për shkak të problematikave të ndryshme”

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

EMILJAN JANI

